

VENDIM
Nr. 532, datë 25.9.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “LEJE RIKONSTRUKSIONI TË NDËRTESES SË DËMTUAR, PA SHTIM APO NDRYSHIM VOLUMI, PËR PROJEKTIN ‘PËRFORCIMI I PALLATIT 1300’, BASHKIA VLORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Leje rikonstruksioni të ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim volumi, për projektin ‘Përforcimi i pallatit 1300’, Bashkia Vlorë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 5 533 752 (pesë milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 5 533 752 (pesë milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh përballohet nga Bashkia Vlorë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Vlorë, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Vlorë, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Vlorë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E
PROJEKTTIT “LEJE RIKONSTRUKSIONI TË NDËRTESES SË DËMTUAR, PA SHTIM APO
NDRYSHIM VOLUMI PËR PROJEKTIN, ‘PËRFORCIMI I PALLATIT 1300’, BASHKIA
VLORË”

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Volum	Faqe	Truall m ²	Ndërtesë m ²	Adresa	Sipërfaqe trualli për shpronësim	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtësës	Shënime
1	Mujsi Delo Lamaj	8604	19/237/1	Truall	72	197	50	50	Vlorë	50	6,899.00	344,950.00			
2	Mujsi Delo Lamaj	8604	19/237/2	Truall	72	198	50	50	Vlorë	50	6,899.00	344,950.00	4,843,852.00	5,533,752.00	
Vlera totale												689,900.00	4,843,852.00	5,533,752.00	